

Policia jep detaje për grabitjen në Suharekë, tregon si iu ikën 4 hajnat: Vendosën pengesa, ishin me maska e armë



22/11/2023 21:09



Policia ka dhënë sërish detaje për grabitjen me armë zjarri në një argjendari në Suharekë, me ç'rast një polic u plagos, një tjetër u lëndua kurse u vodh ar në vlerë rreth 250 mijë euro.

Policia ka bërë se me të mbërritur në vendngjarje, të dyshuarit kanë shtënë me armë në drejtim të policisë. Ata kanë njoftuar se të dyshuarit ishin përveçse të armatosur, edhe të maskuar.

“Të dyshuarit ishin të maskuar dhe të armatosur, posa patrulla policore ka mbërri në vend ngjarje të dyshuarit kanë shtën me armë zjarri në drejtim të policisë, me atë rast një zyrtar policor është plagosur lehtë nga arma e zjarrit, ndërsa një tjetër zyrtar policor është lënduar gjatë aksionit”, ka bërë të ditur PK-ja.

Sipas policisë, gjatë ndjekies së të dyshuarve, të njëjtit kanë vendosur pengesa rrugës.

“Të dyshuarit janë larguar nga vendi dhe policët iu janë vënë pas, gjatë rrugës të dyshuarit kanë vendosur pengesa të ndryshme dhe kanë arrit që të arratisën”, thuhet në njoftim.

Për kapjen e katër të dyshuarve, policia ka kërkuar ndihmën e qytetarëve.

“Ftojm gjithashtu të gjithë qytetarët që kanë çfardo informacioni që mund të na ndihmon në kapjen e kryesve të këtij rasti të kontaktojnë policinë”, bëhet e ditur tutje.

LAJME TË FUNDIT



“Ka një zë që të lë përshtypje”, Lumbardhi...



Në Speciale vazhdon gjykimi ndaj Pjetër Shalës



Këto do të jenë temperaturat për ditën e sotme



Mblidhen deputetët, diskutohet për Raportin e Progresit

Artikuj të ngjashëm



November 23, 2023

Në Speciale vazhdon gjykimi ndaj Pjetër Shalës



November 22, 2023

Si u plagos në 11 të natës nga ushtari serb dhe...



November 23, 2023

Këto do të jenë temperaturat për ditën e sotme



November 22, 2023

PE-ja propozon ndryshimin e traktatit të BE-së dhe heqjen e vetos...



November 23, 2023

Mblidhen deputetët, diskutohet për Raportin e Progresit



November 22, 2023

Dy muaj nga bastisja, ende asnjë vendim për vilat e Radojçiqit

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information